

AKT THEMELIMI



Sot me daten 15.12.2001, ne Tirane z.Hysen Vadenja, shtetas shqiptar, i biri Aliut dhe i *Stefan Keli*, lindur ne Tirane me 11.04.1969, banues ne Tirane ne rrugen " Vllazen Huta", nr.28 dhe Amdi Farka, i biri i Hasanit dhe i *Stefan*, lindur ne Tirane me 10.05.1955, mbeshtetur ne ligjin nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" bien dakort per themelimin e nje shoqerije tregtare me pergjegjesi te kufizuar me kushtet si me poshte:

Neni 1

Themelohet shoqerija tregtare me pergjegjesi te kufizuar "MOTO TIRANA " Sh.P.K. Themelues te shoqerise jane z.Hsen vadenja dhe z. Amdi farka, te cilt si ortak zotrojne kapitalin themeltar te shoqerise sipas percaktimeve te bera ne kete akt themelimi.

Neni 2

Shoqerija "MOTO TIRANA " Sh.P.K., me poshte e quajtur thjesht shoqerija eshte person juridik Shqiptar. Vemprimtarija e saj zhvillohet ne baze te legjislacionit shqiptar dhe akteve te themelimit.

Neni 3

Shoqerija e shtrin aktivitetin e saj ne te gjithë teritorin e Republikës se Shqiperise. Ajo mund te çele filiale, dege apo agjensi edhe ne vende te tjera, ne perputhje me legjislacionin e vendit perkates.

Neni 4

Shoqerija krijohet per te vepruar per nje afat 10 vjeçar. Nje vit para mbarimit te ketij afati ortakët mund te bien dakort per vazhdimin e veprimtarise edhe per nje afat tjeter 10 vjeçar.

Neni 5

Shoqerija e ka seline ne Tirane, rruga "Vllazen Huta", pallati nr.28. Selija e shoqerise mund te ndryshoj vetem me vendim te asamblese se ortakëve, duke respektuar njekohsisht procedurat ligjore.

Neni 6

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte: "Import dhe eksport. Tregti me shumice e pakice I motoreve te markave te ndryshme, I makinerive bujqeore, mjeteve lundruese dhe pjeseve te kembimit; Eksport- import dhe tregetim i mallrave te tjera, ushqimore e industriale dhe lendeve te para industriale e te ndertimit; grumbullim, perpunim e tregetim i produkteve bujqesore, natyrore e blektorale; transporti i mallrave e udhetarve si dhe veprimtari komisionere".

Neni 7

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100000 leke i ndare ne dhjete pjese te barabarta, sejcila me vlere nominale 10000 leke.

Kapitali themeltar zotrohet 6 pjese ose 60 perqind nga ortaku Hysen Vadenja dhe 4 pjese ose 40 perqind nga ortaku Amdi Farka.

Neni 8

Kapitali themeltar eshte i shprehur tersisht ne leke, i shlyer plotesisht nga ortaket duke derdhur shumen perkatese ne banke.

Neni 9

Kapitali themeltar mund te rritet ne kushtet e percaktuara ne ligjin per shoqerite tregtare.

Dispozitat e ketij ligji zbatohen edhe per rastet e trashegimise.

Neni 10


Ortaket, ne rastet e kerkeses per tjetersimin e pjeseve, kane te drjeten e parablerjes se pjeses, teresisht ose pjeserisht.

Neni 11

Organet drjetuese te shoqerise jane:

1. Asambleja e ortakeve
2. Administratori

Modalitetet e thirrjes dhe te funksionimit te asamblese se ortakeve percaktohen ne statut.



Neni 12

Veprimtaria e shoqerise percaktohet ne bilancet financjare. Ne rastet e realizimit te fitimeve, sipas percaketimit te asamblese se ortakeve, ndahet edhe dividend.

Pjesemarrja e ortakeve ne dividendin e shoqerise eshte sipas percaktimit te bere nga Asambleja.

Neni 13

Ortaket pergjigjen per humbjet e shoqerise ne raport me kontributin e tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Neni 14

Shoqerija mund te likujdohet edhe para afatit te percaktuar ne kete akt themelim ne rastet e meposhteme:

1. Me vendim te asamblese se ortakeve,
2. Ne baze te ligjit.


Procedurat e likujdimit jane ato te percaktuara nga ligji.

Neni 15

Norma te hollesishme per veprimtarine e shoqerise percaktohen ne statutin e shoqerise qe eshte pjese perberse e ketij akt themelimi.

ORTAKET THEMELUES

1. Hysen Vadenja
2. Amdi farka



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

NR

8758


REP

296

V E R T E T I M


Ne Tirane sot me daten 20.12.2001 (njezet
Dhjetor te vitit dymije e nje) para meje
noteres Dhimitra Qarri e rregjistruar prane
Dhomes se Noterise Tirane , me zyre
Noteriale ne Tirane Bul "gjergj Fishta , u
paraqiten personalisht

Hysen Ali Vadenja, , I datlindjes
11.04.1965,, banues ne Tirane Rr "Vllazen
Huta ",pallati 28 me identitet te siguar
nga leternjoftimi I tij dhe Amdi hasan
Farka, i datlindjes 10.05.1955 ,banues ne
Tirane Rr "Barrikadave vila nr 2 per
identitetin e te cilit I sigurova nga
leternjoftimi I tij , qe te dy madhore me
zotesi te plote juridike per te vepruat, te
cilet me vullnetin e tyre te lire e te plote
sdeklaruan se sa me siper eshte redaktuar
prej tyre jashte kesaj zyre noteriale, e
nenshkruajne ne pranine time dhe une noterja
e vertetoj ate .



NOTERE

DHIMITRA QARRI





STATUTI

I SHOQERISE "MOTO TIRANA" Sh.P.K.

Ne baze te ligjit nr. 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe mbeshtetur ne aktin e themelimit, ortaket themelues nxjerrin kete statut per veprimtarine e shoqerise "MOTO TIRANA" Sh.P.K.

Neni 1

Z. Hysen Vadenja dhe Amdi Farka ne ortakeri kane themeluar shoqerine me pergjegjesi te kufizuar, me emertimin "MOTO TIRANA" Sh.P.K.

Neni 2

Shoqerija "MOTO TIRANA" Sh.P.K, me poshte e quajtur thjesht shoqerija, eshte person juridik shqiptar. Veprimtaria e sajë zhvillohet ne baze te legjislacionit shqiptar dhe normave te aktit te themelimit e te statutit te shoqerise.

Neni 3

Shoqerija e ka seline ne Tirane, rruga "Vllazen Huta" Pll.nr.21. Selija e shoqerise mund te ndryshoj vetem me vendim te asamblese se ortakeve duke respektuar njekohsisht procedurat ligjore.

Neni 4

Shoqerija e shtrin aktivitetin e sajë ne te gjithë teritorin e Republikës se Shqiperise. Ajo mund te çele filiale, dege, agjensi apo perfaqesi edhe ne vende te tjera, ne perputhje me legjislacionin e vendit perkates.

Neni 5

Shoqerija krijohet per te vepruar per nje afat 10 vjeçar. Nje vit para mbarimit te ketij afati ortaket mund te bien dakort per vazhdimin e veprimtarise edhe per nje afat tjeter 10 vjeçar.

Neni 6

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte: "Import dhe eksport. Tregti me shumice e pakice I motoreve te markave te ndryshme, I makinerive bujqesore, mjeteve lundruese dhe pjeseve te kembimit; Eksport- import dhe tregetim i mallrave te tjera, ushqimore e industriale dhe lendeve te para industriale e te ndertimit; grumbullim, perpunim e tregetim i produkteve bujqesore, natyrore e blektorale; transporti i mallrave e udhetarve si dhe veprimtari komisionere".

Neni 7

Objekti i veprimtarise se shoqerise mund te shtohet ose paksohet me vendim te asamblese se ortakeve, duke respektuar proçedurat e kerkuara nga ligji.

Neni 8

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100000 leke i ndare ne dhjete pjese te barabarta, sejcila me vlere nominale 10000 leke.

Neni 9

Kapitali themeltar zotrohet nga ortaket si me poshte:

1. Z. Hysen vadenja gjshte pjese ose 60 perqind,
2. Z. Amdi farka kater pjese ose 40 perqind.

Neni 10

Kapitali themeltar eshte i shprehur tersisht ne leke, i shlyer plotesisht dhe sejcili nga ortaket ka likujduar pjeset e veta duke derdhur shumat perkatese ne banke.

Neni 11

Rritja ose zvogelimi i kapitalit themeltar behet me vendim te asamblese se ortakeve, por gjithnje me miratim unanim te te gjithë ortakeve zoterues te pjeseve te barabarta te kapitalit themeltar.

Proçedurat e rritjes apo zvogelimit te kapitalit themeltar behen duke respektuar kerkesat e legjislacionit ne fuqi.

Neni 12

Ortaket kane te drejten e parablerjes kur eshte rasti i tjetersimit te pjeseve te barabarta te nje ortaku tjeter tersisht ose pjeserisht.


Ne rast te mosrealizimit te te drejtes se parablerjes ortaku kerkues ka te drejten te beje tjetersimin e pjeseve tek te tretet.

Neni 13

Pjeset e barabarta te kapitalit themeltar jane te trashgueshme. Proçedurat per trashgueshmerine realizohen duke zbatuar dispozitat pekatese te ligjit per shoqerite tregtare.

Neni 14

Organet drjetuese te shoqerise jane:
Asambleja e ortakeve.
Administratori



Neni 15

Asambleja e ortakeve perbehet nga ortaket themelues ose zotrues te pjeseve te barabarta ne kapitalin temelor te shoqerise.

112

Asambleja thirret nga njeri prej administratoreve ose nga njeri prej ortakeve, panvarsisht nga pjeset e barabarta qe ai zotron, jo me rralle se 1 here ne vit.

Neni 16

Lajmerimi per thirrjen e asamblese behet me shkrim dhe dergohet jo me von se 15 dite para dates se zhvillimit te mbledhjes. Njoftimi duhet te permbaj rendin e dites te mbledhjes, vendin, daten dhe oren e zhvillimit te saje si dhe menyren e fitohjes me materialet qe do paraqiten ne mbledhje.

Neni 17

Administratori i shoqerise jane pergjegjes per thirrjen e Asamblese, panvarsisht nga personat qe kerkuar thirrjen. Ata jane pergjegjes gjithashtu edhe per pergaditjen e te gjitha materialeve qe do te paraqiten sipas rendit te dites.

Neni 18

Asambleja e ortakeve vendos:
Miratimin e plan biznesit dhe te bilancit financiar vjetor te shoqerise,
Rritjen apo zvoglimin e kapitalit themelor te shoqerise,
Ndryshimet ne aktin e themelimit e ne statutin e shoqerise,
Zgjerimin apo ngushtimin e objektit te veprimtarise se shoqerise,
Hapjen apo mbylljen e filialeve, degeve, agjensive e perfaqesive,
Celjen e llogarive rrjedhese ne banka te tjera, pervec asaj ku eshte detdhur kapitali themelor,
Menyren e ndarjes se fitimeve dhe masen e dividetit,
Emerimin e shkarkimin e administratoreve dhe percaktimin e shperblimit te tyre,
Miratimin e struktures se shoqerise e te nivelit te pagave te punonjesve.

Neni 19

Asambleja per problemet qe shqyrton merr vendime. Vendimet e Asamblese merren me shumicen e thjeshte te votave, me perjashtim te rasteve te parashikuara shprehimisht ne kete statut.

Vendimet e Asamblese nenshkruhen nga te gjithe ortaket. Ato jane te detyrueshme per t'u zbatuar nga shoqerija dhe administratoret e saje.

Neni 20

Administrimi i zakonshem i shoqerise i perket administratorit. Administratori i shoqerise emerohet nga Asambleja e ortakeve per nje periudhe kohe prej 4 vjetesh me te drejte rizjedhje.

A handwritten signature in black ink is written over a circular stamp. The stamp contains the text 'REPUBLIKA E SHQIPERISE' and 'TIRANE' around the perimeter, with a central emblem. The signature is written in a cursive style.

Neni 21

Administrator i shoqerise per periudhen e pare 4 vjeçare do jete z. Hysen Vadenja.

Neni 22

Administratori i shoqerise eshte pergjegjes per zhvillimin e veprimtarise se shoqerise ne perputhje me legjislacionin ne fuqi si dhe me normat e statutit.

Neni 23

Administratori ka kompetencen e emerimit te personelit teknik si dhe te çdo punonjesi tjetër, ne perputhje me strukturen e miratuar nga Asambleja e ortakeve.

Emerimet e largimet nga puna behen ne perputhje te plote me legjislacionin e punes.

Neni 24

Per zhvillimin e veprimtarise se shoqerise administratori pergjigjet para asamblese se ortakeve.

Neni 25

Administratori eshte i detyruar t'u jape ortakeve çdo informacion qe ata e gjykojne te dobishem per njohjen e veprimtarise se shoqerise.

Neni 26

Administratori dhe gjithe punonjesit e shoqerise jane te detyruar te respektojne normat e caktuara per dhenjen e informatave per veprimtarine e shoqerise.

Neni 27

Veprimtarija e shoqerise pasqyrohet ne bilancet financiare. Shoqerija eshte e detyruar te mbaje nje kontabilitet te rregullt sipas gjithe dispozitave ne fuqi dhe te respektoje afatet kohore per paraqitjen e dokumentacionit perkates ne zyrat e tatimeve.

Neni 28

Viti ushtrimor i shoqerise eshte ai i percaktuar ne planin unik kontabel. Ai fillon ne daten 1 Janar te çdo viti dhe mbaron ne daten 31 Dhjetor. Ne mbyllje te vitit ushtrimor administratori eshte i detyruar te marre masa per hartimin e bilancit financiar si dhe, kur eshte rasti, kontrollin e tij nga ekspert kontabel te autorizuar.

Alton Asim

Neni 29

Fitimi qe mund te realizoj shoqerija perdoret sipas percaktimeve qe ben Asambleja e Ortakeve.

Ne rast te percaktimit te dividendeve ato ndahen sipas vendimit qe merr Asambleja e Ortakeve.

Neni 30

Mbyllja e veprimtarise se shoqerise para afatit mund te behet:
Me vendim te Asamblese se Ortakeve,
Ne baze te ligjit.

Neni 31

Ne çdo rast te mbylljes se veprimtarise se shoqerise respektohen procedurat perkatese ligjore.

Te ardhurat qe sigurohen nga likujdimi i shoqerise, mbas pagimit te te gjithë detyrimeve, ndahen ndermjet ortakeve sipas pjesmarrjes se tyre ne kapitalin themelor.

Neni 32

Ndryshimet ne kete statut behen vetem me vendim te Asamblese se Ortakeve, me miratim unanim te te gjithë ortakeve zotrues te pjeseve te barabarta ne kapitalin themeltar te shoqerise.

ORTAKET:

1. Hysen Vadenja
2. Amdi Farka

